



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 18.10.2017, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Komisionit të Pavarur për Media, Bordi i RTK-së dhe drejtori i përgjithshëm, OSBE-së, GAP, INPO, BIRN, SPRTK, KTV, RTK, Kosova-Info, Koha Ditore dhe Epoka e Re.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit, me këtë

Rend të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.10.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2016;
5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2016;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me një ndryshim, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.10.2017

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2016

Kryetari i komisionit e njoftoi komisionin që raporti i KPMSHCK është shqyrtuar nga komisioni në legjislaturën e kaluar dhe komisioni ka nxjerrë rekomandimin për miratim në Kuvend, por sipas rregullores së Kuvendit çështjet e papërfunduara, kthehen në pikën zero dhe në legjislaturën e re, komisioni shqyrton raportin e punës për vitin 2016.

Ai, kërkoi nga kryetari i KPMSHCK të prezantojë përmbajtjen e raportit.

Shkëmb Manaj, (kryetar i KPMSHCK), e njoftoi komisionin që raporti përmban punët e kryera, në kuadër të funksionimit të zgjidhjes së ankesave për vitin 2016, të shërbyesve civilë dhe kandidatëve të cilët kanë aplikuar në shërbimin civil, funksionet e vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civilë në pozitat e larta drejtuese, si dhe funksionet e zbatimit dhe mbikëqyrjes së rregullave dhe parimeve të legjislacionet në fuqi.

Raporti përmban edhe përfaqësimin e Këshillit në procedurat gjyqësore. Gjithashtu, në tabela të raportit janë të shënuara edhe të gjitha të dhënat për secilin institucion. Ankesat e shqyrtuara, ankesat e hedhura, jokompetenca e Këshillit për raste të caktuara të ankesave, e tjera, të cilat janë të publikuara.

Nait Hasani duke e njoftuar Këshillin për disa vendime dhe ankesa që i janë adresuar komisionit, pyeti për zbatueshmërinë e vendimeve të Këshillit nga institucionet përkatëse, a është organ detyrues Këshilli?

Shqipe Pantina duke vlerësuar punën e Këshillit në raport me institucionet tjera, ajo propozoi, që për mos zbatueshmërinë e rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit nga institucionet, që Kuvendi të përcaktojë zbatueshmërinë e vendimeve dhe sanksionimin e institucioneve për mos zbatueshmërinë e vendimeve të Këshillit, me ndryshimin e Ligjit në fuqi.

Ajo gjithashtu pyeti, se a është monitoruar Kuvendi, Presidenca dhe Gjykata Kushtetuese, dhe kërkoi që në vitin e ardhshëm, pjesë e raportit të jenë edhe të dhënat e monitorimit të shërbyesve civil në institucionet e sipërshënuara.

Xhevahire Izmaku pyeti për procedurat e komisioneve disiplinore brenda institucionit, për rekrutimet në nivelin lokal dhe rreth ankesave të nëpunësve civilë në raport me punëdhënësin.

Jasmina Zhivkoviq tha se në raport janë të shënuara të dhënat për punësimin e minoriteteve në shifrat e përcaktuara me ligj, prej dhjetë për qind, por këto të dhëna nuk janë në pajtueshmëri me të dhënat në terren, sipas raportit të Komisionit Parlamentar për komunitete të hartuar nga monitorimi i gjendjes në terren.

Komisioni miratoi unanimisht Raportin e KPMSHCK-së, për vitin 2016 dhe nxori këtë,

Rekomandim

1. Të miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2016.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ia paraqet raportin vjetor të punës Kuvendit të Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 18.10.2017, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2016 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2016

Adnan Merovci prezantoi Raportin vjetor për vitin 2016, duke e njoftuar komisionin që raporti është i përgjithshëm, përmbledhje e raporteve periodike të vitit 2016. Në raport janë përfshirë aktivitetet e KPM-së, aplikacionet për licenca, ankesat, nga se KPM-ja është rregullator i transmetuesve, ofruesve të shërbimeve audio-vizuele, që funksion kryesor ka rregullimin e frekuencave dhe licencimin, gjithashtu, ai njoftoi komisionin edhe për rregulloret e KPM-së për digjitalizimin.

Nait Hasani duke komentuar lidhur me raportin tha se në raport përfshihen ankesa, kërkesa, rekomandime, si dhe objektivat për vitin 2017, ndërsa te monitorimet dhe revokimi i licencave pyeti për masat që janë ndërmarrë në rastet e revokimit të licencave, çka duhet Kuvendi të bëjë që antena e Goleshit të jetë aktive duke e ditur se 1/3 e banorëve të Kosovës nuk ka mbulueshmëri frekuencore dhe vetëm 62 përqind të territorit mbulon me frekuencë, çka duhet të bëjë KPM-ja për rritjen e mbulueshmërisë.

Shqipe Pantina tha se raporti është më tepër një procesverbal, për arsye se nuk përmban të gjitha çështjet që u prezantuan në Komision, si çështja e mos implementimit të digjitalizimit, pastaj rregullorja për komunikime komerciale sipas së cilës KPM-ja shqipton vetëm vërejtje, por për ata afrues të shërbimeve të cilët kanë disa vërejtje, kanë bërë disa herë shkelje, nuk janë pjesë e raportit, lidhur me këtë KPM-ja nuk ka rekomandime apo kërkesa për plotësim - ndryshimin e rregulloreve, dhe lidhur me borxhin që RTK-ja e ka ndaj KPM-së për vite me radhë dhe RTK-ja nuk e ka paguar.

Xhevahire Izmaku tha se për dallim nga puna e KPM-së që është për të vlerësuar, raporti është i mangët, ajo pyeti lidhur me mospagesat jo të rregullta të gazetarëve.

Komisioni miratoi unanimisht Raportin e KPM-së, për vitin 2016 dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2016.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 3, paragrafi 2, pika 8, të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, KPM-ja ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës deri më 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit, si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 18.10.2017, shqyrtoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, dhe vlerësoi se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radio -Televizionit të Kosovës për vitin 2016

Kryetari i komisionit e njoftoi komisionin që raporti i punës së RTK-së, për vitin 2016, sipas afateve ligjore dhe praktikave të kaluara shqyrtohet në muajin prill të çdo viti kalendarik, por raporti nuk është shqyrtuar në legjislaturën e kaluar për arsye të shpërbërjes së Kuvendit. Ai, kërkoi nga kryetarja e Bordit të RTK-së, të prezantojë raportin.

Afërdita Maliqi, kryetare e Bordit, njoftoi komisionin për sfidat me të cilat po përballlet RTK-ja, të cilat po e përcjellin RTK-në prej vitit në vit. Sfidë kryesore e RTK-së sipas saj janë, mangësitë e ligjit dhe mosmiratimi i plotësim- ndryshimit të Ligjit për RTK-në, mos ndarja e buxhetit të RTK-së për vitin 2018, mos definimi i pronës, vonesat në digjitalizimin e RTK-së dhe arkivit të RTK-së.

Mentor Shala, drejtor i RTK-së, tha pavarësisht me problemet me të cilat po ballafaqohet RTK-ja, vitin kalendarik 2016, RTK-ja e ka përmbyllur me ngritje të shikueshmërisë dhe besueshmërisë, duke qenë të parët.

Kryetari i komisionit, sa i përket definimit të pronës çështja mund zgjidhet nëse ka vullnet të dyanshëm nga palët, ndërsa për çështjen e digjitalizimit të arkivit duhet reaguar shpejt.

Shqipe Pantina tha se RTK-ja është institucioni që nuk menaxhon drejt me paranë publike dhe për këtë fajtor është Kuvendi i Kosovës-themeluesi që nuk kërkon llogaridhënie.

Xhevahire Izmaku, tha se, është për t'u vlerësuar që në RTK ka zhvillime sa i përket kualitetit programor, ndërsa propozoi që të shikohet dhe të kërkohet se sa është e drejtë që raporti i punës së transmetuesit publik të shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend, duke potencuar se në asnjë vend në rajon nuk shqyrtohet raporti i transmetuesit publik në Parlament.

Komisioni me shumicë votash "Për" dhe një "Abstenim", miratoi Raportin e RTK-së, për vitin 2016 dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2016.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 21, paragrafi 6, pika 1 dhe të nenit 38.4 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës ia dorëzon Kuvendit raportin vjetor të aktiviteteve jo më vonë se 31 mars, si dhe raportin vjetor për debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së për qëllime orientuese.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 18.10.2017, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe vlerësoi se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën: 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani